

# Vlerësimi i rrezikut të korrupsionit në sektorin e industrisë nxjerrëse në Kosovë

Gjetjet dhe rekomandimet


---



50  
YEARS

Empowered lives. Resilient nations.







---

# PROGRAMI PËR ZHVILLIM I KOMBEVE TË BASHKUARA 2016

Hulumtimi dhe shkrimi i raportit është një përpjekje e përbashkët mes programit të UNDP-së “Industritë Nxjerrëse për Zhvillim të Qëndrueshëm” të zyrës së UNDP-së për mbështetje të politikave dhe programeve me seli në Nju-Jork, dhe ekipit të projektit të UNDP-së “Mbështetje në Përpjekjet Kundër-Korrupsionit në Kosovë” (SAEK) me seli në Prishtinë, Kosovë

Analizat dhe përfundimet e këtij raporti nuk paraqesin medoemos opinionet e UNDP-së apo SDC-së. Referimet ndaj Kosovës në këtë raport (përfshirë edhe faqen e parë) duhet të kuptohen në kontekstin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999). Përcaktimet e përdorura dhe materialet e prezantuara në gjithë

tekstin e këtij raporti nuk paraqesin çfarëdo opinion të shprehur nga ana e UNDP në lidhje me statusin ligjor të vendit, territorit, zonës apo autoriteteve të tij apo në lidhje me kufijtë e tij.

Vlerësimi i rrezikut të korrupsioni në industrinë nxjerrëse në Kosovë (2016) nuk do mund të publikohet pa mbështetjen e madhe nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

---

# MIRËNJOHJE

## Hulumtimi dhe analiza:

**Cornelius Graubner**, Konsulent i pavarur

## Me mbështetje të:

**Sofi Halling**, Analiste e politikave për industrinë nxjerrëse dhe zhvillim të qëndrueshëm, zyra e UNDP për mbështetje të politikave dhe programeve, Nju-Jork

**Shqipe Neziri Vela**, Menaxhuese e Projektit,  
Projekti “Mbështetje për Përpjekjet Kundër-Korrupsionit në Kosovë”  
(SAEK)

**Petrit Skenderi**, Këshilltar kundër korrupsionit,  
Projekti “Mbështetje për Përpjekjet Kundër-Korrupsionit në Kosovë”  
(SAEK)

**Mato Meyer**, Kryespecialisti teknik – kundër korrupsionit,  
Projekti “Mbështetje për Përpjekjet Kundër-Korrupsionit në Kosovë”  
(SAEK)



---

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>Lista e shkurtesave</b>	<b>fq. 8</b>
<b>Lista e figurave</b>	<b>fq. 9</b>
<b>Përmbledhja ekzekutive</b>	<b>fq. 10</b>
<b>Historiku</b>	<b>fq. 12</b>
Politika dhe ekonomia e Kosovës	<b>fq. 15</b>
<b>Sektori i industrive nxjerrëse</b>	<b>fq. 16</b>
Rezervat dhe rëndësia ekonomike	<b>fq. 16</b>
Kosova dhe Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse	<b>fq. 20</b>
Institucionet dhe ndërmarrjet kyçe në sektorin e minierave: Mandati, Roli, dhe përgjegjësitë	<b>fq. 23</b>
Korniza ligjore	<b>fq. 25</b>
<b>Rreziku nga korrupsioni</b>	<b>fq. 27</b>
Hartimi i politikave, kornizave institucionale dhe ligjore	<b>fq. 28</b>
Dhënia e kontratave dhe licencave	<b>fq. 29</b>
Rregullimi dhe monitorimi i operacioneve	<b>fq. 31</b>
Mbledhja e tatimeve dhe rentave minerare	<b>fq. 32</b>
Gjetjet kyçe: Rreziqet nga korrupsionit në sektorin e industrive nxjerrëse të Kosovës	<b>fq. 33</b>
<b>Rekomandimet</b>	<b>fq. 36</b>
<b>Bibliografia</b>	<b>fq. 40</b>

---

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>NTIN</b>	Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
<b>ZRRO</b>	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
<b>KPMM</b>	Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KFOR</b>	Forca e Kosovës
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Kosovës
<b>MPBZHR</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
<b>MZHE</b>	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>SAEK</b>	Mbështetje për Përpjekjet Kundër-Korrupsionit në Kosovë
<b>UNDP</b>	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
<b>UNMIK</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë



---

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1: <b>Lista e institucioneve të intervistuar</b>	fq. 14
Figura 2: <b>Harta e minierave në Kosovë</b>	fq. 16
Figura 3: <b>Totali i rentës së burimeve natyrore si pjesë e BPV</b>	fq. 17
Figura 4: <b>Standardi i NTIN</b>	fq. 21
Figura 5: <b>Procesi i NTIN për validim</b>	fq. 22
Figura 6: <b>Harta e “Zonave me interes të veçantë”</b>	fq. 30
Figura 7: <b>Rreziku nga korrupsioni në Sektorin e Industrive Nxjerrëse të Kosovës</b>	fq. 33

---

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet të gjeturat e vlerësimit të rrezikut nga korrupsioni në sektorin e industrive nxjerrëse në Kosovë të kryer si pjesë e projektit Mbështetje për Përpjekjet Kundër-Korrupsionit në Kosovë (2012-2020) me mbështetjen e programit të UNDP-së Industrinë nxjerrëse për zhvillim të qëndrueshëm në New York. Vlerësimi përbëhet nga një hulumtim i ligjeve dhe dokumenteve përkatëse rregullative që rregullojnë veprimtarinë e industrisë nxjerrëse në Kosovë si dhe intervistat të kryera me akterët kryesor që janë aktivë në këtë industri, përfshirë ministrinë, institucionet rregullative, përfaqësuesit e industrisë, shoqërinë civile, akademinë dhe mediat. Raporti është vlerësimi i parë që pason hartimin e metodologjisë së UNDP-së në New York për vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni për industrinë nxjerrëse, i cili merr parasysh gjasat dhe ndikimin e korrupsionit përgjatë zinxhirit të vlerave të qeverisjes.

Analizat e rrezikut nga korrupsioni në sektorin e industrive nxjerrëse tregojnë që rreziqet kryesore janë në nivel të licencave dhe negociimit të kontratave si dhe në monitorimin dhe përputhshmërinë rregullative. Licencat dhe negociimi i kontratave në veçanti është një fushë e rëndësishme, pasi që sistemi i regjistrimit në të cilin regjistrohen licencat përbënë bazën për të gjitha fazat e mëvonshme, përfshirë edhe mbledhjen e tatimeve. Ekspozimi më i lartë ndaj rreziqeve nga korrupsioni në këtë fushë mund të pengojë përpjekjet e mëtejshme për rregullimin dhe kontrollimin e sektorit përmes institucioneve demokratike, dhe të siguroj që të ardhurat nga burimet mbliidhen dhe llogariten në mënyrë adekuate.

Në lidhje me licencat dhe negociimin e kontratave, si rreziqe të nivelit të lartë janë identifikuar të dhënat e vjetra nga matjet gjeodezike si dhe mungesa e një regjistri të hapur dhe të dobishëm të licencave dhe kontratave, ndërsa sistemi “vjen i pari, shërbehesh i pari” për dhënien e licencave është përcaktuar të jetë rrezik i nivelit të mesëm. Sa i përket monitorimit dhe përputhshmërisë rregullative, si fusha me rrezik të lartë janë përfshirë monitorimi jo-efektiv i përmbushjes, proceset jo-efektive gjyqësore dhe gjobat e ulëta për veprimtarin ilegale.

Duke u bazuar në analizat e detajuara të rreziqeve, raporti rekomandon ndryshime në kornizën ligjore për të ribalancuar kompetencat mes Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) dhe Departamentit

për Miniera dhe Minerale në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), si dhe prezantimin e një sistemi të licencimit të bazuar në tenderim. Në veçanti, raporti rekomandon që:

- Të ndahet procesi i licencimeve nga KPMM dhe integrimi i tij në Departamentin për Miniera dhe Minerale në MZHE.
- Të krijohet dhe mbahet një të kuptuar i mirë i bazës së burimeve në territorin e Kosovës;
- Licencat të jepen përmes tenderimit në vend se të u jepen koncesioneve në bazë të parimit “vjen i pari, shërbehesh i pari” dhe të prezantohet sistemi i e-tenderimit.
- Të sigurohet publikimi i informatave mbi licencat dhe kontratat përmes një portali online të kadastrit të minierave.
- Të implementohet një sistemi më i mirë i menaxhimit të ankesave për publikun në mënyrë që të raportoj shkeljet e licencave dhe çështjet e ndërlidhura;
- Të përshpejtohen proceset gjyqësore për shkeljet në industrinë nxjerrëse, dhe të caktohen gjoba më adekuate;
- Të sigurohet shpalosja e plotë e të hyrave vjetore nga aktivitetet nxjerrëse në një format të veçantë të bazuar në të dhënat e matjeve gjeodezike;
- Të inkurajohet komunikimi pro-aktiv në të gjitha çështjet që ndërlidhen me politikat e veprimtarisë nxjerrëse

---

## HISTORIKU

Industria nxjerrëse e Kosovës është me rëndësi të madhe politike si dhe me rëndësi ekonomike. Lokacionet kyçe të mihjes që dikur gjatë kohës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ishin burim i pasurisë dhe krenarisë përtej krahinës autonome, që nga ajo kohë janë kthyer në vende të protestave dhe grevave të urisë të cilat paralajmëruan shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe ndaluan prodhimin gjatë viteve të trazirave dhe konfliktit në fund të viteve 1990. Në ditët e sotme ky sektor përbënë më pak se 2% të BPV-së dhe prodhon në një nivel që është mesatar si në aspekt të standardeve rajonale ashtu edhe në bazë të atyre botërore.<sup>1</sup> Megjithatë, industrinë nxjerrëse vazhdojnë të jenë pika kyçe e debateve në lidhje me statusin politik, identitetin kombëtar, potencialin ekonomik dhe korrupsionin.

Ky fenomen nuk kufizohet vetëm me Kosovën. Sektori i industrisë nxjerrëse ka qenë fokusi i diskutimit në lidhje me korrupsionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në shumë pjesë të botës. Pavarësisht potencialit të madh për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës dhe krijimit të një pasurie të qëndrueshme për qytetarët e saj, në shumë raste edhe vendet e tjera të pasura me burime nuk është se performojnë më mirë – apo ka raste që performojnë edhe më keq - sa i përket indikatorëve kyç ekonomik dhe qeverisës. Disa prej faktorëve të cilët e bëjnë sektorin e industrisë nxjerrëse të rrezikuar nga menaxhimi i keq dhe krijojnë mundësi për korrupsion janë flukset e mëdha hyrëse të kapitalit investues që janë të domosdoshëm për zhvillimin e sektorit, rentat nga burimet e mëdha të cilat veprimtarinë nxjerrëse mund të gjenerojnë në kushtet e favorshme të tregut botëror, aranzhimet e ndërlikuara kontraktuale mes qeverive dhe kompanive, rëndësinë strategjike të prodhimit të burimeve dhe vendosjen e aseteve të specializuara lartë.

Ky është vlerësimi i tretë në kuadër të një serie të vlerësimeve të rreziqeve nga korrupsioni në sektorët me rëndësi të madhe për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës, i koordinuar nga projekti i UNDP në Kosovë “Mbështetje në Përpjekjet Kundër-Korrupsionit në Kosovë”(SAEK). Projekti SAEK fokusohet në vlerësimet kundër korrupsionit që janë specifike për një sektor të cilat i adresojnë rrjedhjet dhe menaxhimin e keq të burimeve të alokuara për promovimin e integritetit institucional në këtë sektor.

---

<sup>1</sup> Shih nivelet e prodhimit për metalet kryesore dhe thëngjillin në USGS (2014). Libri i vjetor i mineraleve për vitin 2012. Evropa dhe Euro-Azia Qendrore [Botim i avancuar]. Reston, VA: së SHBA Shërbimi Gjeologjik. Marrë nga <http://minerals.usgs.gov/minerals/pubs/Kosovo/2012/myb3-sum-2012-europe-eurasia.pdf>, fq. 15 - 33

Gjithashtu, ky dokument është vlerësimi i parë që pason zhvillimin e metodologjisë nga UNDP për vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni në industrinë nxjerrëse. Ky “Udhëzues për praktikuesit mbi Zbutjen e Rrezikut nga Korrupsioni në Industrinë Nxjerrëse” kërkon të mbështes vendin në zhvillimin e kornizës ligjore si dhe mjeteve dhe qasjeve për adresimin dhe zbutjen e rreziqeve nga korrupsioni në sektorin e industrive nxjerrëse.

Dokumenti ofron një kornizë për identifikimin, analizimin dhe zbutjen e rreziqeve nga korrupsionit para se ato të materializohen në humbje të pasurive të burimeve natyrore nga të cilat përndryshe do të përfitonin shoqëritë. Në mënyrë të veçantë, dokumenti ndihmon në identifikimin e rreziqeve të korrupsionit në fazat e ndryshme të nxjerrjes së burimeve, zhvillimin e një plani për zbutjen efektive të rreziqeve nga korrupsioni si dhe monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të rreziqeve nga korrupsioni në industrinë nxjerrëse.

Për qëllim të këtij dokumenti, korrupsioni përkufizohet si abuzim i kompetencave për përfitime personale dhe ne e kufizojmë vlerësimin tonë në burimet nxjerrëse të përcaktuara si burime jo të rinovueshme, burime minerale dhe naftë.

Nëntëdhjetë e shtatë (97) përqind e energjisë së Kosovës prodhohet nga termocentralet që përdorin si lëndë djegëse thëngjillin e nxjerr në vend. Si rezultat i kësaj, sektori i industrisë nxjerrëse dhe sektori i energjisë në Kosovë janë të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin. Megjithatë, në këtë vlerësim fokusohemi vetëm në industrinë nxjerrëse për arsye metodologjike. Kjo do të thotë se megjithëse çështjet në lidhje me sigurinë energjetike janë përfshirë në shumë prej bisedave në hulumtimin për këtë raport, analiza përfundon në momentin që thëngjilli arrin në termocentral. Raporti ndjek zinxhirin e vlerave të menaxhimit të industrive nxjerrëse dhe shqyrton rreziqet nga rreziku në nivelet e mëposhtme:

- Hartimin e politikave, kornizave institucionale dhe ligjore;
- Dhënien e kontratave dhe licencave;
- Rregullimin dhe monitorimin e operacioneve;
- Mbledhjen e tatimeve dhe rentave minerare;
- Shpërndarjen dhe menaxhimin e të ardhurave.

Dy faktor ofrojnë informata për analizën e rrezikut të korrupsionit: së pari, gjasat që rreziku i identifikuar të ndodh, dhe së dyti - ndikimi material që do të kishte rreziku, nëse do të ndodhte.

Për këtë raport, hulumtimi fillestar i kornizës ligjore që rregullon veprimtarinë e sektorit nxjerrës është përcjell edhe me një javë të intervistave në Kosovë, të mbajtura në nëntor të vitit 2015 nga një ekspertë ndërkombëtar mbi menaxhimin e burimeve të nxjerra dhe një analist nga Njësia e UNDP-së e

Industritë Nxjerrëse për Zhvillim të Qëndrueshëm. Të dhënat e nxjerra nga analiza ligjore dhe intervistat u plotësuan me materialet të cilat u siguruan nga bashkëbiseduesit dhe rrjetet personale të autorëve, si dhe materialet nga burimet e hapura. Më pas, një draft-raport u është dërguar akterëve kryesorë me ftesën që të komentojnë. Në muajin shkurt të vitit 2016 u organizua një takim shqyrtues si mundësi shtesë për të diskutuar gjetjet dhe rekomandimet e raportit. Komentet, kritikrat dhe opinionet e marra janë sistemuar dhe përfshirë në versionin përfundimtar.

*Tabela 1: Lista e Institucioneve të intervistuar*

<b>Ministritë</b>	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Departamenti për Miniera dhe Minerale
<b>Kuvendi i Kosovës</b>	Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri
<b>Dega e gjyqësorit</b>	Këshilli Prokurorial, Njësia për Krime Ekonomike
<b>Institucionet e pavarura</b>	Agjencia kundër Korrupsionit Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
<b>Institucionet rregullatore</b>	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale Zyra e Rregullatorit për Energji
<b>Përfaqësuesit e industrialisë</b>	Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë Kompani për mihje (dëshiron të mbetet anonim)
<b>Shoqëria civile</b>	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur KOSID Çohu – Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese Iniciativa Evropiane për Stabilitet Ekspertë të ndryshëm të pavarur
<b>Media</b>	Zeri Kallxo.com
<b>Organizatrat e donatorëve</b>	Banka Botërore UNDP USAID GIZ

---

# POLITIKAT DHE EKONOMIA E KOSOVËS

Kosova është një territor në Evropën Juglindore që nuk ka dalje në det. Ajo është e vogël si në aspektin e popullsisë ashtu edhe të sipërfaqes, me rreth 1.8 milionë banor që jetojnë në më pak se 11,000 km katrorë. Dendësia e popullsisë prej 167.5<sup>2</sup> banorë për metër/katror është dukshëm më e lartë se dendësia e popullsisë së vendeve fqinje.

Tranzicioni drejt një ekonomie të tregut si dhe historia kohëve të fundit me trazira, së bashku me problemet e mbetura strukturore, e kufizojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ekonomia mbetet e vogël dhe me potencial të kufizuar, gjë që e bën atë të ndjeshme ndaj zhvillimeve të jashtme. Sektorët kryesorë të ekonomisë janë shërbimet, industria dhe bujqësia, të cilat përbëjnë 55 përqind, përkatësisht 22, dhe 14 përqind të BPV-së.<sup>3</sup>

Me një BPV pre 3,579 \$ për kokë-banori, me një shkallë të varfërisë prej gati 30 përqind dhe me një shkallë papunësie prej 35.1 përqind, Kosova është një nga vendet më të varfra në Evropë.<sup>4</sup> Kushtet e vështira të tregut të punës janë veçanërisht të rënda për të rinjtë dhe gratë, me një normë papunësie prej 60.2 përqind në mesin e grup-moshave nga 16 deri në 24 vjeç, që është edhe më alarmante kur merret parasysh se rreth 20 për qind e popullsisë bie në atë grup-moshë.

Banka Botërore e klasifikon Kosovën si një “vend me të ardhura të ulëta-të mesme me një performancë solide të rritjes ekonomike që nga përfundimi i luftës në vitin 1999”, por vë në dukje se kjo rritje është vetëm e pjeshme për shkak të vetë politikave ekonomike të qeverisë.<sup>5</sup> Normat impresionuese të rritjes prej 3.4 përqind në vitin 2013 dhe 3.3 përqind në vitin 2014 (vlerësim)<sup>6</sup> janë mbi normat evropiane dhe pjesërisht mund të shpjegohen duke marr parasysh se kanë filluar nga një bazë e ulët. Një variabël tjetër e rëndësishme e që kontribuon në normën e rritjes është përbërja pro-rritje e buxhetit të Kosovës, megjithatë qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës bazohet në faktorët e jashtëm, siç është integrimi i limituar i Kosovës në tregjet botërore, remitancat e mëdha nga diaspora që kryesisht gjendet në Evropë, dhe flukset hyrëse të mbështetjes nga donatorët.

2 Banka Botërore (2015). World Development Indicators. Marr nga: <http://databank.worldbank.org/data/reports.aspx?source=2&Kosovo=KSV&series=&period=>

3 Qeveria e Kosovës (2015). 2015 Programi Kombëtar i Reformës Ekonomike (NERP). Prishtinë: Qeveria e Kosovës. Marrë nga <https://mf.rks-gov.net/en-us/Reports/Reports-and-Publications/National-Economic-Reform-Programme>, p. 19

4 UNDP Kosovo Info Kosovo. Marrë nga <http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/Kosovoinfo.html>

5 Pasqyra e Bankës Botërore për Kosovën. Marr nga: <http://www.worldbank.org/en/Kosovo/kosovo/overview>

6 Qeveria e Kosovës (2015), p. 18



# SEKTORI I INDUSTRIVE NXJERRËSE

## Rezervat dhe rëndësia ekonomike

Industritë nxjerrëse janë një sektor me rëndësi historike në Kosovë, si në aspektin e ekonomisë ashtu edhe të identitetit kombëtar. Kosova ka rezerva të konsiderueshme të lëndëve djegëse minerale - me shumicë dërrmuese të thëngjillit- dhe ka rezerva të mëdha të metaleve bazë, mineraleve industriale, dhe disa metaleve të çmuara.




Figura 2: Harta e Minierave në Kosovë

Resursi më i rëndësishëm është linjiti, i cili arrin në rreth 12,442,461,000 ton në rezervat gjeologjike në tre basenet kryesore (të Kosovës, Dukagjinit dhe Drenicës)<sup>7</sup>. Kjo e vë Kosovën në vendin e 5 në aspektin e madhësisë së rezervave të provuara të linjtit, prapa Gjermanisë, Australisë, SHBA-ve dhe Kinës. Linjiti është minerali kryesor energjetik në Kosovë. Ai kontribuon me 97 përqind të prodhimit të energjisë elektrike të Kosovës dhe nxirret ekskluzivisht nga Korporata Energjetike të Kosovës (KEK), e cila është në pronësi të Qeverisë.

Një aset tjetër kyç mineral është nxjerrja e plumbit dhe zinkut në kompleksin Trepça. Me rezerva të llogaritura prej 2,615,578 ton të plumbit dhe 2,508,321 ton të zinkut,<sup>8</sup> Trepça ka potencial të konsiderueshëm dhe

<sup>7</sup> Qeveria e Kosovës (2012). Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012 - 2025. Prishtinë: Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Marrë nga

<sup>8</sup> Qeveria e Kosovës (2012), f. 24

dikur gjatë viteve 1980 punësonte mbi 20.000 punëtorë. Minierat gjithashtu ruajnë një vend të rëndësishëm në kujtesën kolektive si të shqiptarëve ashtu edhe të serbëve të Kosovës, pasi që një nga grevat e para masovike në vitin 1989<sup>9</sup> që nxitën shpërbërjen e Jugosllavisë u zhvillua këtu. Miniera është e ndarë me një pjesë në territorin e komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës, dhe një pjesë që kontrollohet nga qeveria, dhe vazhdon të jetë objekt i betejave të ashpra rreth identitetit kombëtar dhe pronësisë.<sup>10</sup>

Nikeli është një mineral tjetër i rëndësishëm në Kosovë, dhe shfrytëzohet kryesisht nga NewCo Ferronikeli në Drenas. Rezervat këtu vlerësohen të jenë 13.000 ton xehe me një përmbajtje mesatare të nikelit prej 1.31 për qind.<sup>11</sup> Resurset e tjera kyçe nxjerrëse janë argjendi, kromi, boksiti, magnetiti, mineralet e rralla të tokës si dhe materialet ndërtimore.

### Totali i qirave të burimeve natyrore (% e BPV)




Figura 3: Renta totale nga resurset natyrore (renta minerare) si pjesë e PBP<sup>12</sup>

Në vitin 2005, Banka Botërore ka vlerësuar se burimet minerale të Kosovës janë në vlerë prej 13.5 miliardë euro dhe të afta për gjenerimin e 35,000 vendeve të punës.<sup>13</sup> Megjithatë, realizimi i këtyre potencialeve është dëshmuar të jetë problematik dhe deri tani prodhimi i mineraleve në Kosovë vazhdon të jetë i vogël në krahasim me standardet rajonale dhe botërore. Midis vitit 2004 dhe 2013, pjesa e rentës nga burimet natyrore në

9 Grupi Ndërkombëtar i Krizave (1999). Trepça. Zbërthimi i Labirintit. ICG Raporti për Ballkanin Nr. 82. Uashington dhe Prishtinë: Grupi Ndërkombëtar i Krizave. Marrë nga <http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/Kosovo%2015.pdf>, f. 2

10 Hopkins, Valerie (2015). Set the Trojan Horse on Fire (Futini zjarrin kalit të trojes). Në: Foreign Policy, Shkurt 4, 2015. Marrë nga <http://foreignpolicy.com/2015/02/04/set-the-trojan-horse-on-fire-kosovo-serbia-protests-mining/>

11 Qeveria e Kosovës (2012), f. 25

12 Banka Botërore (2015). Të dhënat e Bankës Botërore. Marrë nga: <http://data.ëorlëbank.org/indicator/NY.GDP.TOTL.RT.ZS>

13 Raporti për Kosovën (2005). Sondazhi i Bankës Botërore vlerëson burimet minerare të Kosovës të jenë në vlerë prej 13.5 miliardë euro. Marrë nga <http://kosovareport.blogspot.com/2005/01/world-bank-survey-puts-kosovos-mineral.html>

BPV të Kosovës, ka qenë mesatarisht 1.5 për qind (shih figura 3). Sipas Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), në nëntor të vitit 2015 ekzistonin 241 operacione të licencuara minerare në Kosovë<sup>14</sup>, të cilat në vitin 2012 punësonin pak më shumë se 3000 punëtorë.<sup>15</sup> Ndërkohë që linjiti nxirret vetëm për konsumin e brendshëm vendor të energjisë, metalet bazë dhe mineralet janë produkte të rëndësishme të eksportit. Në vitin 2013, vlera totale e eksporteve të Kosovës ishte 293,9 milionë €. Metalet bazë përbënin për rreth 144 milionë € në eksporte (49 për qind), ndërsa eksportet e produkteve të tjera minerare u vlerësuan në një vlerë shtesë prej 48.2 milionë € (16 për qind). Edhe pse mbresëlënëse në letër, pjesa e metaleve bazë në totalin e eksporteve ka rënë nga 63 për qind në vitin 2009, dhe vazhdon të bjerë ndërkohë që sektorë të tjerë të ekonomisë së Kosovës, si ato të ushqimeve të përgatitura dhe pijeve, tekstileve, produkteve bimore dhe plastike janë duke fituar rëndësi në raport me mineralet dhe metalet<sup>16</sup>.

Zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve të sektorit nxjerrës në Kosovë është i komplikuar për shkak të një sërë faktorësh. Së pari, pronësia e konglomeratit Trepça paraqet rreziqe të konsiderueshme ligjore dhe politike kur bëhet fjalë për çfarëdo diskutimi rreth pronësisë private. Përveç kësaj, rënia masive e çmimeve për mallra e nxjerra - përfshirë mineralet dhe metalet të eksportuara nga Kosova - të cilat arritën majat e tyre historike në vitin 2014, dhe ka gjasa të vazhdojnë në periudhën afatmesme, si dhe e kufizon fizibilitetin ekonomik të shumë projekteve. Këta faktorë kufizojnë disponueshmërinë e investimeve të jashtme të nevojshme për të zbatuar nxjerrjen moderne të metaleve në përputhje me legjislacionin mjedisor të BE-së dhe standardet e tjera.

Strategjia e Energjisë e Kosovës 2009 - 2018 është përqendruar në zhvillimin e një sektori energjetik me bazë linjitin. Kjo do të kërkonte një zgjerim të rëndësishëm të nxjerrjes krahasuar me nivelet aktuale, e kjo është objekt i një debati kontraversal në mesin e aktorëve kyç në Kosovë. Linjiti ka nxehtësinë më të ulët dhe përmbajtjen më ulët të karbonit nga të gjitha llojet e thëngjillit dhe prodhon nivele të larta të emisioneve të ndotjes së ajrit. Për shkak të peshës së lartë në krahasim me vlerën e tij kalorifike të lëndës djegëse, ai përdoret kryesisht në termocentrale të afërta me vendet ku nxirret dhe rrallë transportohet në distanca të gjata. Kjo flet kundër asaj që vetë linjiti të paraqesë një potencial të rëndësishëm të eksportit. Një tjetër mundësi për të përfituar nga rezervat e konsiderueshme të linjtit do të ishte të shtohen kapacitetet e gjenerimit për eksport. Megjithatë, ndërtimi i termocentraleve me bazë thëngjilli me një kapacitet prodhues që tejkalon konsumin e brendshëm të Kosovës, që është e nevojshme për të hapur mundësinë e eksportit të energjisë

14 Intervistë me KPMM, Pristinë, Nëntor 2015

15 Qeveria e Kosovës (2014). Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2014. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës. Marrë nga <https://ask.rks-gov.net/ENG/dmdocuments/STATISTICAL%20YEARBOOK%202014.pdf>, f. 142

16 Qeveria e Kosovës (2015), f. 20

elektrike në rajon, do të kërkonte investime të konsiderueshme në infrastrukturën e prodhimit dhe infrastrukturën shtesë të transmisionit. Fizibiliteti ekonomik i projekteve të tilla nuk është i garantuar duke pasur parasysh kostot e investimeve, si dhe kostot sociale, mjedisore dhe politike lidhur me një projekt të tillë.<sup>17</sup> Ndërkombëtarisht, zhvillimi i projekteve të mihjes së thëngjillit në përgjithësi dhe linjtit në mënyrë të veçantë është bërë më i vështirë për kompanitë e minierave, pasi që çmimet për qymyr kanë rënë dhe kundërshtimi publik kundër përdorimit të lëndëve djegëse fosile për prodhimin e energjisë është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Ekspertët llogarisin se 72.8 për qind e burimeve të lëndëve djegëse fosile të Evropës duhet të mbeten nëntokë, për të mbajtur ngrohjen globale nën pikën referuese prej 2 gradë Celsius.<sup>18</sup> Kompanitë më të mëdha në botë të minierave janë tashmë duke braktisur në heshtje thëngjillit<sup>19</sup>, dhe disa nga investitorët më të rëndësishëm institucional janë duke hequr dorë nga pasuritë e tyre të thëngjillit.<sup>20</sup> Rreziku klimatik rrit koston e kapitalit për investimet e nevojshme në një sektor të energjisë të bazuar në linjit. Kritikët e zhvillimit të resurseve të linjtit të Kosovës përmes mihjeve sipërfaqësore edhe më tutje e theksojnë dendësinë e lartë të popullsisë, burimet e kufizuara ujore në zonat e pasura me linjit dhe konfliktet e mundshme me nevojat për zhvillimin e bujqësisë në lidhje me përdorimin e tokës së punueshme.<sup>21</sup> Zhvendosja e rreth 7,000 njerëzve, e nevojshme për zgjerimin e një termocentrali me thëngjill, e financuar nga Banka Botërore është në zhvillim e sipër, por është dëshmuar të jetë kontraversale, e gjatë dhe e kushtueshme. Që nga dhjetori 2015, është duke u hetuar një ankesë formale e qytetarëve drejtuar Panelit të Inspektimit të Bankës Botërore, e parashtruar në qershor 2015.<sup>22</sup> Kundrejt këtyre trendëve, qëllimi i qeverisë për të zgjeruar nxjerrjen e linjtit në mënyrë që të zhvillojë më tej një sektor të energjisë të bazuar në thëngjill duket mjaft ambicioz.

Duke pasur parasysh këto kufizime, gjasat janë që Kosova do të mbetet një prodhues modest i mallrave minerare, përfshirë linjtin, dhe se sektori i industrive nxjerrëse do të mbetet mbrapa në krahasim me sektorët tjerë specifik të industrisë (vertikalëve) pavarësisht shprehjeve të shpeshta të interesit të konsiderueshëm publik për zhvillimin e sektorit.

17 Për një pasqyrë të problemeve që lidhen me gjenerimin e energjisë elektrike të mjaftueshme për përbushjen e kërkesës së brendshme shih Banka Botërore (2012). Mbështetja e Grupit të Bankës Botërore për sektorin e energjisë në Kosovë. Washington, DC: World Bank Group. Marrë nga [http://siteresources.worldbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/297769-1329940905064/kosovo\\_slideshow.pdf](http://siteresources.worldbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/297769-1329940905064/kosovo_slideshow.pdf)

18 Novethic (2015). Risque Carbone. Conséquences Financières de la Dévalorisation des Energies Fossiles. Marrë nga <http://www.novethic.fr/climat/risque-carbone.html>

19 Grigg, Angus (2015). BHP and Rio are quietly exciting coal. In: Australian Financial Review Weekend, December 2, 2015. Marrë nga <http://www.afr.com/business/mining/coal/bhp-and-rio-tinto-are-quietly-exiting-coal-20151202-gldo0o>

20 Hower, Mike (2015). Morgan Stanley, Wells Fargo Join Banks Cutting Out Coal. In: Sustainable Brands, December 1, 2015. Retrieved from: [http://www.sustainablebrands.com/news\\_and\\_views/behavior\\_change/mike\\_hower/morgan\\_stanley\\_wells\\_fargo\\_join\\_banks\\_cutting\\_out\\_coal](http://www.sustainablebrands.com/news_and_views/behavior_change/mike_hower/morgan_stanley_wells_fargo_join_banks_cutting_out_coal) Also: Esser, Christian, Sha Hua and Martina Moraëietz (2015). Allianz Will Investments aus der Kohleindustrie abziehen. In: ZDF Frontal21, November 24, 2015. Retrieved from <http://www.zdf.de/frontal-21/allianz-ausstieg-aus-der-kohle-41104912.html>

21 Shllaku, Luan edhe Ekrem Beqiri (2007). Një Përrallë Moderne – Kosova C 2100. Prishtinë: Fondacioni I Kosovës për Shoqëri të Hapur. Marrë nga <http://kfos.org/ep-content/uploads/2012/04/A-Modern-Tale.pdf>

22 <http://ewebapps.worldbank.org/apps/ip/Pages/ViewCase.aspx?CaseId=108>

## Kosova dhe Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse


Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (NTIN) është një koalicion global i qeverive, kompanive, dhe shoqërisë civile, që punojnë së bashku për të përmirësuar menaxhimin e hapur dhe llogaridhënës të të ardhurave nga resurset natyrore. NTIN u lansua për herë të parë në shtator të vitit 2002 në Samitin e Bankës Botërore për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Johannesburg. NTIN mban Standardin e NTIN, një udhëzues për nxitjen e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes më të mirë në vendet që janë të pasura me naftë, gaz dhe resurse minerale.

Minimalisht, NTIN kërkon nga vendet pjesëmarrëse të zbatojnë shtatë kërkesa:

1. Mbikëqyrje efektive nga një grup me shumë akterë;
2. Publikimi në kohë të raporteve NTIN;
3. Raportet NTIN të përfshijnë informata kontekstuale për industrinë nxjerrëse;
4. Prodhimi i raporteve gjithëpërfshirëse NTIN që përfshijnë shpalosjen e plotë nga qeveria të ardhurave nga industrisë nxjerrëse, dhe shpalosjen e të gjitha pagesave materiale bërë për qeverinë nga ana e kompanive të naftës, gazit, dhe kompanitë e minierave;
5. Një procesi i besueshëm i sigurimit duke zbatuar standardet ndërkombëtare;
6. Raporte NTIN të jenë të kuptueshme, të promovohen në mënyrë aktive, të jenë të hapura për publikun, si dhe të kontribuojnë në debatin publik;
7. Grupi prej shumë akterësh të marrë hapa për të vepruar në mësimet e nxjerra dhe të shqyrtojë rezultatet dhe ndikimin e zbatimit të NTIN;

Vendet inkurajohen në mënyrë eksplicite të shkojnë përtej këtyre standardeve minimale aty ku akterët kombëtarë pajtohen se kjo është e përshtatshme.

Mjeti më i rëndësishëm që NTIN e përdor për të dokumentuar përpjekjet drejt promovimit të transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes më të mirë në ekonominë nxjerrëse është publikimi i raporteve NTIN në nivel kombëtar nga vendet pjesëmarrëse. Këto raporte kanë për qëllim që të shpalosin të ardhurat nga nxjerrja e burimeve natyrore të Kosovës. Kompanitë raportojnë pagesat për qeverinë – tatimet, rentat minerare, etj - dhe qeveria raporton të ardhurat që ka marrë. Shifrat auditohen dhe barazohen nga një administrator i pavarur.




#### Prova 4: Standardi EITI <sup>23</sup>

Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm që përdor NTIN për promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes më të mirë në ekonomitë nxjerrëse është përshkrimi i statusit të shteteve pjesëmarrëse. Shtetet mund të përcaktohen ose si “shtet aplikant” ose si “shtet në pajtueshmëri”. Pajtueshmëria konfirmohet me anë të një mekanizmi të validimit që mbikëqyret nga Bordi global i NTIN. Statusi “në përputhje me NTIN” do të thotë se Bordi global i NTIN konfirmon se vendi në fjalë ka përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në Standardin NTIN.

<sup>23</sup> Figura e marrë nga Iniciativa për Transparencë në Industritë Nxjerrëse (2013). Standardi EITI . Oslo: Sekretariati i EITI . Marrë nga [https://eiti.org/files/English\\_EITI%20STANDARD\\_11July\\_0.pdf](https://eiti.org/files/English_EITI%20STANDARD_11July_0.pdf), f. 8

Të pranuar si Kandidat → Validimi i parë brenda 2.5 viteve

A janë plotësuar gjitha kërkesat?



Prova5: Procesi i validimit i EIT<sup>24</sup>

Në Kosovë, Ministria e Punëve të Jashtme ka shprehur interesimin që t'i bashkohet NTIN (Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse). Për këtë qëllim, një delegacion që përfshinte një anëtar të Parlamentit organizoi një takim të përbashkët me zyrtarë nga Shqipëria - një shtet që është në përputhje me NTIN- për të mësuar më shumë për iniciativën dhe për të hulumtuar opsionet për Kosovën, por sidoqoftë nuk ka pasur rezultate konkrete të këtij udhëtimi. Sekretariati Ndërkombëtar i NTIN, një zyrë që mbështet Bordin global të NTIN, ka qenë i kujdesshëm në lidhje me perspektivën e Kosovës për t'iu bashkuar NTIN. Pjesa e rentës nga burimet natyrore në BPV-në kombëtare të Kosovës është më e ulët se në shumicën e vendeve që tradicionalisht do të konsideroheshin si të pasura me resurse nxjerrëse. Shpenzimet e larta të krijimit të një sekretariati kombëtar NTIN për zbatimin e NTIN në nivel kombëtar do të kërkonte financim nga donatorë të jashtëm, gjë kjo e cila mund të kufizojë ndjenjën e pronësisë kombëtare mbi këtë iniciativë.

24 Ibid., p. 16



## Institucionet dhe Ndërmarrjet kryesore të Sektorit Minerar: Mandati, Roli dhe Përgjegjësitë

**Kuvendi i Kosovës:** Kuvendi i Kosovës është dega legjislative e Kosovës. Nga 120 anëtarët e saj, 100 janë të zgjedhur me vota, ndërsa 20 janë pjesëtarë të minoriteteve kombëtare. Kuvendi diskuton dhe miraton të gjitha ligjet. Nëpërmjet komisioneve të tij, Kuvendi zgjedh anëtarët e bordit të organeve të pavarura rregullative siç është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, si dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Ai gjithashtu mund të kërkojë raportim nga Bordi i Drejtorëve të këtyre institucioneve të pavarura dhe kjo zakonisht ndodh dy herë në vit.

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE):** MZHE, përmes Departamentit për Miniera dhe Minerale, është agjencia qendrore përgjegjëse për hartimin e legjislacionit, politikave dhe strategjive për sektorin minerar. Një përgjegjësi tjetër kryesore është grumbullimi sistematik, arkivimi, hartimi, përpunimi dhe publikimi i të gjitha të dhënave gjeo-shkencore mbi burimet gjeologjike të Kosovës. Departamenti për Miniera dhe Minerale aktualisht ka një staf prej tre personash dhe një buxhet vjetor prej \$ 35,000<sup>25</sup>. Gjithashtu, MZHE ka Departamentin e Energjisë, i cili merret me çështjet minerare vetëm për aq sa këto kanë të bëjnë me nxjerrjen e linjtit për të furnizuar dy termocentralet me lëndë djegëse nga fosilet, përkatësisht Kosova A dhe Kosova B. MZHE është ministria pasardhëse e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave.

**Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM):** KPMM është institucioni më i rëndësishëm në sektorin minerar të Kosovës. Ai është autoriteti përgjegjës për lëshimin e licencave, mbikëqyrur dhe monitoruar operacionet dhe për të mbledhur rentat minerare nga kompanitë e minierave. KPMM është një nga organet e paktat rregullative të pavarura në Kosovë, ku drejtori nuk emërohet nga bordi i agjencisë, por drejtpërdrejt nga Kuvendi. Në dhjetor të vitit 2015, ishin 241 operacione të licencuara minerare, prej të cilave asnjë nuk është licencuar nëpërmjet një procesi të tenderimit. Komisioni punëson 13 inspektorë që kishin kryer 1.720 inspektime në vitin 2015, nga të cilat 16 ishin kryer në fundjavë. KPMM gjithashtu operon një linjë telefonike për të pranuar ankesat e qytetarëve.<sup>26</sup>

**Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE):** ZRRE është përgjegjëse për të gjitha çështjet rregullative në sektorin e energjisë, i cili përbëhet nga energjia elektrike, ngrohja dhe gazi natyror. Ndër detyrat kryesore është caktimi i tarifave të energjisë elektrike dhe ngrohjes, si dhe dhënia e licencave për kompanitë e sektorit të energjisë. Në aspektin e minierave, autoriteti i kësaj zyre është i kufizuar në mbikëqyrjen e minierave të linjtit të cilat operohen nga Korporata Energjetike e Kosovës që është e integruar vertikalisht dhe e cila operon me dy termocentralet e Kosovës.

<sup>25</sup> Intervistë me Departamentin e Minierave dhe Mineraleve të MZHE, Prishtinë, Nëntor 2015

<sup>26</sup> Intervistë me KPMM, Prishtinë, Nëntor 2015

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH):** MMPH luan rol kyç në rregullimin e aktiviteteve minerare në territorin e Kosovës përmes dhënies së lejeve lidhur me ndikimet në mjedis, përfshirë lejet për ujë dhe shkarkim të ujit. Ajo gjithashtu kryen vlerësimet e ndikimit në mjedis. Këto dokumente janë të nevojshme për aplikim për licencë nga KPMM. Për shkak të këtij funksioni, MMPH gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në hartimin e legjislacionit dytësor që ka të bëjë me mineralet dhe sektorin e minierave. Në një rol tjetër kyç, MMPH-ja mbikëqyr çfarëdo zhvendosje të komunitetit në lidhje me zhvillimin e zonave minerare.

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR):** legjislacioni për minierat dhe mineralet kërkon pëlqimin e MMPH-së dhe autoriteteve të tjera publike, por pyetja se kush i përbënë “autoritetet e tjera publike” mbetet e hapur. KPMM kërkon miratimin nga MBPZHR për aplikimet për licencë për çdo aktivitet të sektorit nxjerrës që është i paraparë për zonat pyjore të menaxhuara nga MBPZHR.

**Autoritetet komunale:** KPMM kërkon miratimin nga komunat për të siguruar që licencat nuk janë në kundërshtim me planifikimin urban apo ndonjë planifikim tjetër të zonave nga ana e komunave. Njëjtë siç me rastin me miratimin nga MBPZHR, baza ligjore për këtë praktikë është përkufizimi i paqartë i “autoriteteve tjera publike”, në ligjin për miniera dhe minerale.

**Agjencia Kosovre e Privatizimit (AKP):** AKP-ja është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit që ishte themeluar nga UNMIK-u për të mbikëqyrur procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë. Asetet për shitje tenderohen për oferta nga investitorët e interesuar. AKP-ja udhëhiqet nga një bord i përbërë prej tetë drejtorëve.

**Korporata Energjetike e Kosovës (KEK):** KEK-u është një ndërmarrje në pronësi publike që ofron shërbime publike të sektorit të energjisë elektrike. Si e tillë, ajo zotëron dhe operon me të gjitha asetet për gjenerimin e energjisë elektrike në Kosovë. Deri në krijimin e Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) në vitin 2013, ajo ishte edhe operatori i vetëm i transmisionit dhe distribuimit. Divizioni i Prodhimit të Qymyrit i KEK-ut operon minierën e linjtit Sibovc Jug-Perëndim, e cila aktualisht punëson 3.600 punonjës.

**Trepça:** është kompania pasardhëse e kompleksit industrial-minerar Trepça të kohës së ish-Jugosllavisë. Ajo përfshinte rreth 40 miniera dhe kompani, dhe në fund të viteve 1980 ka punësuar deri në 22.000 punëtorë dhe përbënte deri në 70 për qind të prodhimit minerar jugosllav. Objektet kryesore ndodhen në qytetin e Mitrovicës, i cili është ende i ndarë në vija etnike. Objekti faktikisht doli nga prodhimi në vitin 1999, dhe sot punëson 2,500 punëtorë plus një numër prej 2500 punëtorë të tjerë, të cilët mbështeten nga skemat e të ardhurave të ulëta të financuara nga buxheti publik.<sup>27</sup>

<sup>27</sup> Qeveria e Kosovës (2012), f. 10

**NewCo Ferronikeli:** Ferronikeli operon dy miniera sipërfaqësore dhe një shkritore në Drenas. Ajo u privatizua në vitin 2006 dhe tani është në pronësi të një konsorciumi izraelito-grek. Aktualisht punëson rreth 1,000 punëtorë.<sup>28</sup>

### **Korniza ligjore**

Sektori nxjerrës në Kosovë rregullohet përmes një numri të ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë të gjitha aspektet e operacioneve minerare gjatë tërë jetëgjatësisë së projektit. Në vijim është një listë e plotë e dokumenteve përkatëse:<sup>29</sup>

- Ligji Nr. 03/L-163 Për Minierat dhe Mineralet (2010);
- Ligji Nr. 04/L-158 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 Për Minierat dhe Mineralet (2013)
- Ligji Nr. 2004/28 Për Punimet Nga Metalet e Çmuara (2004);
- Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (2010);
- Ligji Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (2009);
- Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritetet Publiko-Private (2011);
- Ligji Nr. 03/L-184 për Energjinë (2010);
- Ligji Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë (2010);
- Ligji Nr. 03 / L-201 për Energjinë Elektrike (2010);
- Ligji Nr. 03-L-133 për Gazin Natyror (2009);
- Ligji Nr. 03/L-116 për Ngrohjet Qendrore (2008);
- Ligji Nr. 04 / L-174 për Planifikimin Hapësinor (2013);
- Ligji Nr. 03 / L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (2009);
- Ligji Nr. 04/L-035 Për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre (2011);
- Ligji Nr. 04/L-033 Mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (2011);
- Ligji Nr. 04/L-246 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-033 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës Për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (2014);
- Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (2011);
- Ligji Nr. 2004/42 Për Veprimtarinë Kërkimore - Shkencore (2004);
- Ligji Nr. 04/L-135 Për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (2013);
- Ligji Nr. 04 / L-220 për Investimet e Huaja (2013);
- Ligji Nr. 03 / L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (2010);
- Ligji Nr. 03 / L-087 për Ndërmarrjet Publike (2008);
- Ligji Nr. 04/L-111 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike(2012);
- Ligji Nr 02 / L-123 për Shoqëritë Tregtare (2007);
- Ligji Nr 04 / L-006 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 02 / L-123 për shoqëritë tregtare (2011);

<sup>28</sup> Ibid.

<sup>29</sup> A Baza e të dhënave të ligjeve dhe ndryshimeve është në dispozicion në faqen e internetit të Kuvendit të Kosovës në <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,122>

- Ligji Nr 03 / L-226 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (2012);
- Udhëzimi Administrativ Nr 01/2011 për Rregullat dhe Procedurat për mbledhjen e tatimeve minerale (2011);
- Rregullorja nr. 02/2011 për Përmbajtjen e Programit të Hulumtimeve Gjeologjike dhe Elaboratit të Rezultateve të Hulumtimeve Gjeologjike (2011);
- Rregullorja Nr. 04/2011 për trajtimin e komunitetit në sektorin mineral (2011);
- Rregullorja Nr 05/2011 për Organizimin dhe Funksonimin e Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve (2011);
- Rregullorja Nr 06/2011 për Sigurinë Minerare (2011);
- Vendimi i Qeverisë për politikën e pronësisë për Ndërmarrjet Publike Qendrore nr. 11/39 dhe nr. 13/39;
- Vendimi i Qeverisë për ristrukturim të KEK sha, nr. 06/2005;
- Vendimi i Qeverisë për shthurje të KEK sha, nr. 04/36, 2008
- Vendimi i Qeverisë nr. 02/46 i datës 02.11.2011 për ndalimin e shfrytëzimit të materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës

Diskutimi më i rëndësishëm rreth kornizës ligjore për minierat në Kosovë ka të bëjë me ndryshimet e bëra në vitin 2013 në ligjin për minierat dhe mineralet të vitit 2010. Ndryshimet kryesore që tërhoqën vëmendjen ishin dispozitat që pezullojnë procesin konkurrues jo vetëm për “arsye të sigurisë së energjisë” ose vetëm për bizneset që “operojnë objektet e konsiderueshme të gjenerimit të energjisë” ose furnizojnë qymyr në këto objekte, por edhe për shkak të tërheqjes së “investimeve të konsiderueshme direkte “. Përderisa qeveria vë në dukje se këto ndryshime ishin të nevojshme për tërheqjen e investimeve të huaja direkte, Banka Botërore shprehu se dispozitat më pak kufizuese të tenderimit do të rezultonin në më pak transparencë, dhe presupozimi i aftësisë së KPMM-së për sigurimin e një procesi të duhur në dhënien e licencave, do të ndikojë negativisht në mekanizmat e zbulimit të çmimeve dhe do shpie drejt perceptimit publik për korrupsion në këtë sektor.<sup>30</sup>

30 Olters, Jan-Peter (2014). Operacionet minerale të energjisë: Qëndrueshmëria dhe FDI. Prishtinë: Fjalimi në Qendrën Mjedisit Rajonal dhe Konferenca Baker Tilly në Kosovë. Marrë nga <http://www.worldbank.org/en/news/speech/2014/06/03/remarks-jan-peter-olters-regional-environment-center-baker-tilly-kosovo-conference>

---

## RREZIQET E KORRUPSIONIT

Korrupsioni mbetet një çështje problematike në shumicën, nëse jo në të gjitha vendet e botës, por për shumë vrojtues Kosova përballet me një korrupsion të lartë dhe të rrënjosur thellë. Indeksi i Perceptimit të Korrupsioni (CPI) i Transparency International që përdor një kombinim të sondazheve dhe vlerësimeve të ekspertëve për të matur perceptimin e korrupsionit në sektorin publik në mbarë botën e rendit Kosovën në vendin e 110-të nga 174 vende të botës në publikimin e vitit 2014.<sup>31</sup> Kjo e vë Kosovën - së bashku me Shqipërinë - në vendin e fundit në mesin e fqinjëve të saj në Evropën Juglindore. Një studim i bërë në vitin 2011 nga UNODC konstaton se njerëzit në Kosovë e renditin korrupsionin në jetën e përditshme si problemin e dytë më të rëndësishëm pas papunësisë, si dhe përhapja e korrupsionit është më e lartë në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.<sup>32</sup>

Në sektorin e industrive nxjerrëse, ekziston ndërveprimi mes bizneseve dhe zyrtarëve, kështu që përvoja e korrupsionit dallon nga korrupsioni administrativ të cilin e përjetojnë qytetarët në situatat e jetës së përditshme. Gjithashtu, kjo nënkupton se ekzistojnë më pak të dhëna imperike për ti bazuar analizat përtej të dhënave anekdotike të dhëna nga bashkëbiseduesit dhe tregimet e raportuara në gazeta. Qëllimi i këtij raporti nuk është të zbulohen rastet e perceptuara apo reale të korrupsionit, por të nxjerrë në pah rreziqet në proceset dhe kornizat ligjore që rregullojnë sektorin e industrisë nxjerrëse në Kosovë.

Ky raport i klasifikon rreziqet e korrupsionit si rreziqe të larta, të mesme apo të ulëta, në bazë të gjasave të ndodhjes së korrupsionit dhe vlerësim i ndikimit material të korrupsionit.

---

31 Transparency International (2014). Corruption Perceptions Index 2014: Results. Të marra nga: <http://www.transparency.org/cpi2014/results>

32 UNODC (2011). Corruption in Kosovo: Bribery as Experienced by the Population. Vienna: UNDOC. Të marra nga: [http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/CORRUPTION\\_KOSOVO\\_Population.pdf](http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/CORRUPTION_KOSOVO_Population.pdf), p. 18

## Hartimi i Politikave, Kornizave institucionale dhe ligjore

Korniza ligjore dhe rregullative e ndërlidhur me nxjerrjen e burimeve minerale është bazuar, si shumica e kornizës ligjore dhe rregullatore të Kosovës, në përpjekjet e udhëhequra nga OKB-për shtet-ndërtim nën UNMIK-un pas vitit 2001. Ligji i ri për Miniera dhe Minerale u miratua nga qeveria në vitin 2010, pas shpalljes së pavarësisë, dhe ligji u ndryshua në vitin 2013. Një nga karakteristikat më të pazakonta të kornizës institucionale për qeverisjen e nxjerrjes së burimeve minerale në Kosovë është mungesa e ndarjes ndërmjet funksioneve të licencimit, mbikëqyrjes dhe mbledhjes së të ardhurave që janë të rëndësishme për rregullimin e aktiviteteve nxjerrëse. Funksionet e fuqishme kyçe janë përqendruara në duart e KPMM-së e cila lëshon licenca, monitoron veprimtarinë e kompanive të industrisë nxjerrëse, si dhe mbledh pagesat e rentës minerare. Departamenti i Minerave dhe Mineraleve në MZHE luan një rol të vogël në zhvillimin e mëtejshëm të politikave dhe legjislacionit, dhe përbëhet nga vetëm tre anëtarë të stafit. Zyra e Administratës Tatimore mbledh vetëm tatimin mbi të ardhurat e korporatave, sipas raporteve financiare të raportuara nga kompanitë e industrisë nxjerrëse. Mungesa e ndarjes së kompetencave në funksionet kyçe e rrit rrezikun e abuzimit të diskrecionit të zyrtarëve të KPMM ose perceptimin e saj.

Një çështje potencialisht problematike është kapja e mundshme e procesit të politikës nëpërmjet akterëve të jashtëm industrial. Diskutimet rreth ndryshimit të Ligjit për miniera dhe minerale të vitit 2010 që kanë rezultuar në ndryshimet e ligjit të vitit 2013 ka përkuar me diskutime rreth një investimi të mundshëm prej 8 miliard dollarëve në një projekt masiv nëntokësor të gazifikimit me qymyr<sup>33</sup> të propozuar nga kompania kanadeze Envidity. Në atë kohë, Envidity përfaqësohej nga Wesley Clark, Gjenerali i Përgjithshëm Amerikan i cili ishte në krye të intervenimit të NATO-s gjatë konfliktit në Kosovë dhe i cili nderohet në masë të madhe nga shqiptarët e Kosovës.<sup>34</sup> Ligji i vitit 2010 specifikon se licencat në zonat me miniera të thëngjillit mund të lëshohen vetëm për arsye të sigurisë së energjisë, dhe se vetëm bizneset që operojnë objekte të rëndësishme gjeneruese të energjisë apo furnizojnë me qymyr objektet e tilla, mund të marrin licencën për shfrytëzimin e linjitet. Sipas këtij përkufizimi, projekti Envidity do të ishte i paligjshëm. Ndryshimet e vitit 2013 në ligjin e vitit 2010 e rritin fushëveprimin e licencimit të burimeve të linjitet për të tërhequr investimet e konsiderueshme direkte, gjë që do ta bënte projektin e gazifikimit nëntokësor të qymyreve të ligjshme. Vetë bisedat me përfaqësuesit e

33 Underground coal gasification (UGC) is a technology in which underground coal deposits are converted into gas (mainly methane, hydrogen, carbon monoxide and carbon dioxide) by way of injecting oxidants and steam into coal seams. UGC is in trial stage, and pilots are being conducted in Australia, China, South Africa, and Uzbekistan.

34 Çollaku, Petrit dhe Fatmir Aliu (2012). Wesley Clark kërkon Licencë për naftë në Kosovë. Në: Balkan Insights, 8 qershor 2012. Marrë nga <http://www.balkaninsight.com/en/article/wesley-clark-seeks-licence-for-oil-in-kosovo>

industrive nxjerrëse në Kosovë nuk kanë sugjeruar një nevojë urgjente për të ndryshuar ligjin e vitit 2010 në atë kohë.<sup>35</sup> Përfundimisht, në kohën e përpilimit të projektit të gazifikimit të thëngjillit me projektin Envidity, i njëjti nuk kishte avancuar. Megjithatë, kjo na e kujton ndërtimin e diskutueshëm të dy autostradave me vlerë 2 miliard dollarëve nga kompania e ndërtimit e SHBA Bechtel, e cila përfaqësohej nga ish-ambasadori i SHBA-së në Kosovë, z. Christopher Dell.<sup>36</sup>

## Dhënia e kontratave dhe licencave

Dhënia e kontratave dhe licencave është një fushë veçanërisht e pirur ndaj rreziqeve të korrupsionit në shumë vende që kanë një sektor të madh të industrive nxjerrëse. Në procesin e dhënies së kontratave dhe licencave, kriteret e dhënies, qasja në informata, si dhe procesi i përzgjedhjes mund të manipulohet për përfitime personale, dhe kompanitë mund të tundohen ti bëjnë rryshfet zyrtarëve për të përfituar kushte më të favorshme ose trajtim preferencial.

Në Kosovë, industria nxjerrëse ka rëndësi mesatare për ekonominë kombëtare, megjithatë dhënia e kontratave dhe licencave ka dëshmuar të jetë një zonë problematike. Në një rast të patronazhit të mundshëm të raportuar nga mediat në Kosovë, një kompani e drejtuar nga vëllai i një ish-kryeministri ka regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës një gurore për të prodhuar zhavorr, por guroren nuk e kishte licencuar me KPMM.<sup>37</sup> Ky rast është i një rëndësie të veçantë për shkak se kjo kompani u bë nën-kontraktore kyçe për Bechtel-in në ndërtimin e projektit të diskutueshëm të autostradës, në të cilën dyshohet se zhavorri u buxhetua tri herë më shumë se norma e tregut.<sup>38</sup>

Siç theksohet në Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet (2010) dhe Ligjin nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet (2013)<sup>39</sup>, Kosova vepron me sistemin “vjen i pari – shërbehesh i pari” për të gjitha licencat jashtë njëmbëdhjetë “Zonave me Interes të Veçantë” siç përcaktohet nga qeveria e Kosovës (shih Figurën 6). Në këto zona me interes të veçantë, licencat tenderohen në një proces të udhëhequr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Komisionin për Partneritet Publiko-Privat. Në kohën e shkrimit të këtij

35 Intervistë me Odën Ekonomike Amerikane, Prishtinë, Nëntor 2015

36 Brunwasser, Matthew (2015). Steamrolled. A Special Investigation of Doing Business Abroad. In: Foreign Policy. E marrë nga <http://foreignpolicy.com/2015/01/30/steamrolled-investigation-bechtel-highway-business-kosovo/> Also: Collaku, Petrit et al (2014). Albania-Kosovo Highway Costs Soar To 2 Billion Euros. In: BalkanInsight, April 23, 2014. Retrieved from <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-kosovo-highway-costs-soar-to-2-billion-euro>

37 Liridon Llapashtica (2015). Mbi 200 gurëthyes, demolojnë Kosovën. In: Zeri, June 25, 2015. E marrë nga <http://zeri.info/ekonomia/38764/mbi-200-gurethyes-demolojne-kosoven/>

38 Brunwasser (2015)

39 Kopjet e këtyre ligjeve mund të gjenden në bazën gjithëpërfshirëse të të dhënave të plota të ligjeve dhe ndryshimeve në dispozicion në faqen e internetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,122>



raporti, nuk është tenderuar asnjë licencë aktive. Një rast që është sjellë në vëmendjen e autorëve është se një kompani ka pretenduar se i është mohuar licenca në mënyrë të padrejtë. Për më tepër, KPMM pranoi një aplikacion nga një kompani në ditën e premte por e këshilloi kompaninë që të e tërheqë aplikacionin pasi që nuk i kishte përfshirë të gjitha dokumentet e nevojshme. Kur kompania ri-aplikoi me të gjitha dokumentet e nevojshme të hënën pasuese, asaj ju tha se licenca për atë fushë të veçantë i ishte dhënë një kompanie konkurrenente.<sup>40</sup> Është e paqartë nëse këto ishin rezultate të gabimeve burokratike, klientelizmit apo ndonjë marrëveshje të fshehtë.




Figura 6: Harta e "Zonave me Interes të Veçantë"

Të dhënat e matjeve gjeodezike që nevojiten për rregullimin e fushave të licensimit dhe menaxhimin e rentave minerare është përditësuar në vitin 2009.<sup>41</sup> Kjo kufizon aftësinë e KPMM-së që të menaxhoj me saktësi dhe në mënyrë efektive pagesat për licencat dhe rentat minerare si dhe e vë qeverinë në disavantazh me kompanitë që mund të posedojnë të dhëna me të reja dhe më të sakta gjeo-hapësinore.

Në përgjithësi, Kosovës i mungon një regjistër i hapur dhe i dobishëm i licencave dhe kontratave. Të dhënat e licencës vihen në dispozicion nga KPMM-ja sipas kërkesës, por në disa raste duket sikur informacioni i nevojshëm vihet në dispozicion vetëm pas kryerjes së pagesës<sup>42</sup>, ose nuk vihen fare në dispozicion. Lista që KPMM ka vënë në dispozicion të autorit më 2 dhjetor të vitit 2015 përmbante 241 licenca aktive. Kontratat kryesore si ajo ndërmjet qeverisë dhe NewCo Feronikeli nuk janë fare në dispozicion të publikut.

40 Intervistë me Odën Ekonomike Amerikane, Prishtinë, Nëntor 2015

41 Intervistë me Departamentin e Minerave dhe Mineraleve, MZHE, Prishtinë, nëntor 2015

42 Intervistë me GIZ, Prishtinë, Dhjetor 2015

## Rregullimi dhe Monitorimi i operacioneve

Funksionet kyçe për qeverisjen e burimeve nxjerrëse janë monitorimi efektiv i pajtueshmërisë dhe zbatimi strikt i rregullave mjedisore dhe sociale, si dhe monitorimi teknik për të përcaktuar nivelet e prodhimit në të cilat mund të bazohet menaxhimi i të ardhurave. Praktika e mirë përfshin themelimin e një autoriteti kompetent dhe të pavarur që do ishte përgjegjës për rregullimin dhe monitorimin e operacioneve nxjerrëse, si dhe ndarjen e roleve ndërmjet ministrive dhe organizatave të pavarura.

Megjithëse Kosova ka një kornizë të shëndoshë rregullative e cila përbëhet nga ligjet dhe rregulloret e shumta, si dhe KPMM-në si një autoritet kompetent monitorues, në praktikë vërehen probleme të shumta në rregullimin dhe monitorimin e sektorit. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka raportuar në mënyrë të përsëritur për dështimin e KPMM-së që të kryej në mënyrë efikase detyrat e mbikëqyrjes të caktuara për institucionin. Në veçanti, auditori i përgjithshëm vëren se KPMM-ja në disa raste nuk ka arritur të sigurojë raportim të rregullt në vëllimet e prodhimit të mbajtësve të licencës, nuk ka arritur të revokojë licencat ose lejet për kompanitë që nuk kanë mundur të ofrojnë garanci bankare apo politika të sigurimit, dhe nuk ka arritur të parandalojë operacionet e paligjshme.<sup>43</sup>

Në disa raste gjerësisht të raportuara, individët e lidhur me KPMM janë akuzuar për marrje ryshfeti, dhe në të paktën një rast, një inspektor i lartë është dënua për korrupsion.<sup>44</sup> Në raste të tjera, inspektorët e KPMM nuk kanë qenë në gjendje<sup>45</sup> apo të gatshëm<sup>46</sup> të mbyllin operacionet e paligjshme nxjerrëse, veçanërisht në miniera zhavorri. Një kompani licenca e së cilës është revokuar ka vënë në pikëpyetje ligjshmërinë e vendimeve të KPMM-së<sup>47</sup>, dhe ka speculuar se nepotizmi ka qenë arsyeja për vendimet e KPMM-së dhe jo mospërputhja me rregullat. Në vendndodhjen e NewCo Ferronikelit duket se rregulloret mjedisore shkelen prej vitesh pa ndërhyrje nga KPMM.<sup>48</sup>

Në KPMM, burim kryesor i frustrimit është mungesa e mbështetjes që agjencia merr nga sistemi gjyqësor. Në vitin 2015, janë kryer më shumë se

43 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (2015). Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat e Komisioneve për Miniera dhe Minerale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014. Prishtinë: zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Marrë nga [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KPMM\\_2014\\_Eng\\_377341.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPMM_2014_Eng_377341.pdf)

44 Drejtësia në Kosovë, (2013a). Korrupsioni ne KPMM. In: Drejtësia në Kosovë, 22 dhjetor, 2013. E marrë nga <http://www.drejtësiakosove.com/sq/Emisione/Korrupsioni-ne-KPMM-1054>

45 Drejtësia në Kosovë (2013b). Eksploatimi Ilegal I Zhavorrit. In: Drejtësia në Kosovë, 23 Qershor, 2013. E marrë nga <http://www.drejtësiakosove.com/sq/Emisione/Eksploatimi-ilegal-i-zhavorrit-1026>

46 Drejtësia në Kosovë (2014). Eksploatimi Ilegal I Zhavorrit Në Rajonin E Dukagjinit. në: Drejtësia në Kosovë, 4 maj 2014. E marrë nga <http://www.drejtësiakosove.com/sq/Emisione/Eksploatimi-ilegal-i-zhavorrit-ne-Rajonin-e-Dukagjinit-1096>

47 Xharra, Jeta dhe Petrit Collaku (2012). Fox Marble Cries Foul Over Kosovo Lost Licenses. Në: Balkan Insights, 10 Dhjetor 2012. Marr nga <http://www.balkaninsight.com/en/article/fox-marble-cries-foul-over-kosovo-lost-licenses>

48 Blau, Uri (2011). Israeli Black Hole in Kosovo. In: Haaretz, 12 Gusht, 2011. Marr nga: <http://www.haaretz.com/israel-news/israeli-black-hole-in-kosovo-1.378338>

1700 inspektive, nga të cilat janë identifikuar 65 operacione të paligjshme kryesisht në zhavorr. Të gjitha rastet e operacioneve të paligjshme janë raportuar tek autoritetet e zbatimit të ligjit.

Stafi i KPMM ka përshkruar një situatë ku mungon shpejtësia e procedimit të rasteve nga prokuroria dhe gjykatat dhe në disa raste shkeljet e paligjshme të operimit të parashtuara në vitin 2009 janë ende në pritje. Në rastet kur janë dhënë dënimet, menaxhmenti i KPMM mendonte se gjobat e shqiptuara nga gjykatat nuk janë në përputhje me dëmin mjedisor dhe ekonomik të shkaktuar nga shkelja.<sup>49</sup> Në përgjithësi, menaxhmenti i KPMM-së mendon se ngadalësia e procesit gjyqësor, dhe sasia e vogël e parave që operatorëve të cilit i shkelin rregulla duhet të paguajnë, nuk do të pengojnë në mënyrë efektive operacionet e paligjshme nxjerrëse.<sup>50</sup>

## Mbledhja e tatimeve dhe rentave minerare

Rentat minerare, pagesat e tjera si dhe tatimet mbi të ardhurat e korporatave të gjeneruara nga operacionet e industrive nxjerrëse, mund të arrijnë në shuma të mëdha të ardhurave për institucionet në vendet e pasura me burime. Me qëllim të kufizimit të mundësive të përvetësimit, këshillohet që mbledhja e tatimeve dhe rentave minerare të bëhet në mënyrë sa më transparente që është e mundshme.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm vë në pah se KPMM nuk ka qenë në gjendje të marr raportet e rregulla të kërkuara me ligj mbi sasinë ose volumin e mineraleve të prodhuara nga disa kompani. Shënimet e Auditorit të Përgjithshëm nuk përmbajnë informacion se pse mungojnë raportet për disa kompani. Në këto raste, nuk ka qenë e mundur të përcaktohet me saktësi vlera e detyrimeve që kanë këto kompani ndaj KPMM-së. Për më tepër, auditori i përgjithshëm vëren jo-efikasitetin në mbledhjen e borxhit të krijuar nga kompanitë e minierave.<sup>51</sup> Megjithëse informatat mbi rentat minerare, gjobat dhe tarifat administrative janë në dispozicion sipas kërkesës nga KPMM-ja, Kosovës i mungojnë shpalosjet publike gjithëpërfshirëse proaktive të pagesave të pranuar nga sektori i industrive nxjerrëse nëpërmjet tatimeve, rentave minerare dhe të ardhurave të tjera, në një mënyrë që është e dobishme për publikun e gjerë.

49 Intervistë me KPMM, Prishtinë, Nëntor 2015

50 Intervistë me KPMM, Prishtinë, Nëntor 2015

51 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (2015), p. 14; p.21

## Gjetjet kyçe: Rreziqet nga korrupsioni në sektorin e Industrive nxjerrëse në Kosovë

Siç është detajuar në paragrafët e mësipërm, rreziqet kyçe nga korrupsioni në zinxhirin e vlerave janë në nivel të licencave dhe negociatave të kontratës, si dhe monitorimit dhe përputhshmërisë rregullative. Këto janë fushat në të cilat palët e interesuara duhet të konsiderojnë përqendrimin e reformave të tyre për të lehtësuar shfrytëzimin e barabartë të burimeve natyrore që gjenden në territorin e Kosovës, në bazë të parimeve të transparencës dhe llogaridhënies.

Të gjitha rreziqet e identifikuar në hulumtim dhe gjatë intervistave në terren të kryera për qëllime të raportit janë përmbledhur në tabelën 6 më poshtë. Nivelet e rrezikut janë llogaritur duke vlerësuar gjasat për ndodhjen e korrupsionit dhe ndikimin e mundshëm të korrupsionit, kur akterët për interesa personale të shfrytëzojnë rreziqet.

*Tabela 7: Rreziqet e korrupsionit në sektorin e Industrive Nxjerrëse të Kosovës*

Faza e nxjerrjes	Rreziku i korrupsionit	Niveli i rrezikut	Komente mbi akterët dhe historikun
Hartimi i kornizës së politikave, institucionale dhe ligjore	Mungesa e ndarjes mes funksionit të licencimit, mbikëqyrjes dhe mbledhjes së të ardhurave	I ulët	Përqendrimi i kompetencave në institucionin e KPMM-së tregon ndarjen e dobët të kompetencave ndërmjet akterëve qeveritarë
	Kompanitë nxjerrëse mund të ushtrojnë ndikim të padrejtë në hartimin e politikave	I mesëm	Nuk është e qartë se çfarë ka shkaktuar ndryshimet e bëra në vitin 2013 për ligjin për miniera dhe minerale të vitit 2010, ka pak kërkesa vokale për ndryshime rregullative nga kompanitë vendase

Faza e nxjerrjes	Rreziku i korrupsionit	Niveli i rrezikut	Komente mbi akterët dhe historikun
Licencat dhe negociatat për kontrata	Sistemi “vjen i pari - shërbehet i pari” për dhënien e licencave	I mesëm	Ka disa probleme me sistemin “vjen i pari - shërbehet i pari”; asnjë licencë nuk është dhënë përmes tenderit
	Transferimi i licencave të eksplorimit në licenca të eksplotimit	I ulët	
	Të dhënat e vjetruara të matjeve gjeodezike	I lartë	Të dhënat më të fundit në dispozicion nga viti 2009, e vendosin qeverinë në një disavantazh në negociimin e kontratave dhe licencimit.
	Mungesa e një regjistri të hapur dhe të dobishëm për licencat dhe kontratat.	I lartë	Dobësitë institucionale në gjenerimin, ndarjen dhe përdorimin e informatave në lidhje me aktivitetet minerare e kufizojnë kapacitetin e autoriteteve për planifikimin, kontrollimin dhe ofrimin e shërbimeve për sektorin, dhe ul nivelet e llogaridhënies ndaj qytetarëve.
Monitorimi dhe pajtueshmëria rregullatore	Monitorimi i paefektshëm i pajtueshmërisë	I lartë	MZHE është kritikuar në auditimet qeveritare dhe raportimin medial se ka qenë jo efikase në raste kryesore të monitorimit dhe zbatimit e përputhshmërisë me rregulloret
	Procese jo-efikase gjyqësore	I lartë	Rastet nga viti 2009 dhe më të vjetra janë ende në pritje të vendimit nga gjykata, deri sa të merret vendimi, zhduket efekti ndalues i ndjekjes penale
	Gjoha të ulëta për operacione të paligjshme	I lartë	Niveli i gjobave për operacionet e paligjshme nuk janë përcaktuar me fitimet e bëra dhe/ose dëmet mjedisore të shkaktuara nga operacionet e paligjshme
Mbledhja e tatimeve dhe rentave minerare	Mungesa e shpalosjes të pagesave të marra përmes tatimeve, rentave minerare dhe të ardhurave të tjera në një mënyrë pro-aktive dhe të dobishme	I lartë	Paaftësia për të ndarë dhe përdorur informata mbi të ardhurat që rrjedhin nga minierat dhe veprimtaritë e tjera nxjerrëse çojnë drejt perceptimit publik të korrupsionit në sektor

---

## REKOMANDIMET

Bazuar në gjetjet e hulumtimit dhe intervistat e bëra për qëllime të këtij raporti, autorët kanë përgatitur disa rekomandime për të ndihmuar udhëzimin e menaxhimit të burimeve nxjerrëse në Kosovë

Rekomandimet kyçe përfshijnë ndryshimet në kornizën ligjore që do të rezultojnë në një ri-balancim të kompetencave të cilat i janë dhënë autoritetit të KPMM dhe Departamentit për Miniera dhe Minerale në MZHE si dhe prezantimin e sistemit të licencimit të bazuar në tender që do zëvendësojë qasjen aktuale “vjen i pari, shërbehesh i pari”. Për më tepër, akterët që kanë investuar në rezultate më të mira të eksploatimit të burimeve në Kosovë duhet të marrin në konsideratë gjurmimin e shpejtë të ankesave dhe mosmarrëveshjeve që ndërlidhen me veprimtarinë e industrisë nxjerrëse në sistemin gjyqësor dhe të sigurojnë që gjobat i ndalojnë në mjaftueshëm operacionet e pa-licencuara apo që nuk janë në përputhshmëri me rregulloret përkatëse

Rekomandimet e tjera e inkurajojnë përdorimin më të mirë të teknologjisë dhe të dhënave për të siguruar transparencën dhe qasjen në informata mbi aktivitetet e industrisë nxjerrëse për publikun e gjerë

### **1. Ndarja e procesit të licencimit nga KPMM-ja dhe integrimi i tij në Departamentin për Miniera dhe Minerale në MZHE.**

Koncentrimi i funksioneve të licencimit, monitorimit dhe mbledhjes së të ardhurave në kuadër të KPMM tregon një ndarje të dobët të kompetencave dhe e lë sistemin të cenueshëm ndaj kapjes nga interesat private për shkak të mungesës së kontrolleve dhe balanceve të nevojshme mes akterëve institucional. Ndarja e procesit të licencimit nga funksionet e monitorimit dhe mbledhjes së rentave minerare të KPMM do të krijonte një institucion të fokusuar që do të fuqizonte funksionin e monitorimit në të cilin janë identifikuar shumë fusha problematike. Kjo gjithashtu do të lironte kapacitetet profesionale në kuadër të KPMM –së, që më pas do të mund të zhvillonte më shumë rolin e saj si këshillues në çështjet që ndërlidhen me politiken e minierave dhe aplikimin e legjislacionit në MZHE dhe Kuvendin e Kosovës. Përfshirja e licencimit si shërbim në kuadër të Departamentit të Minierave dhe Minierave të MZHE do të fuqizonte departamentin që aktualisht ka mungesë të stafit dhe fondeve dhe do rezultonte në një balancë më kuptimplotë të kompetencave mes institucioneve. Shembujt e praktikave të mira në dizajnin institucional të sektorit të industrive përfshijnë Norvegjinë, Nigerinë dhe Afrikën e Jugut.

## **2. Krijimi dhe ruajtja e një të kuptuari të mirë të bazës së burimeve në territorin e Kosovës**

Pa e kuptuar thellësisht se cila është sasia dhe cilësia e mineraleve dhe shpërndarjes së tyre gjeografike nuk mund të ketë një bazë të shëndosh për vendime kyçe të informuara në lidhje me vendosjen e të drejtave pronësore dhe licencave si dhe në lidhje me përcaktimin e shkallës së eksploatimit. Gjithashtu, është e pamundur të diskutohen se cilat janë të ardhurat potenciale të ardhshme kundrejt ndikimeve të ardhshme sociale dhe mjedisore. Mungesa e të kuptuarit të bazës së burimeve të Kosovës e vë qeverinë e Kosovës në disavantazh në negociatat me investitorët e jashtëm të cilët mund të kenë një të kuptuar më të detajuar të sasisë, cilësisë dhe lokacionit të burimeve minerale për shkak të kapaciteteve të avancuara teknike. Duke ditur që të dhënat më të fundit në dispozicion nga matjet gjeodezike datojnë nga viti 2009, MZHE duhet të alokoj burime të mjaftueshme për Departamentin e Minierave dhe Metaleve në mënyrë që të mund të ndërtohet dhe mirëmbahet një regjistër i saktë i bazës së burimeve të Kosovës.

## **3. Dhënia e licencave në bazë të ankandeve në vend se të u jepen koncesioneve në bazë të parimit “vjen i pari, shërbehesh i pari”, dhe prezantimi i sistemit të e-tenderimit**

Parimi mbizotërues në ndarjen e licencave është që metoda e miratuar duhet të jetë transparente dhe llogaridhënëse, dhe duhet të përfshijë jo vetëm korrektësinë por edhe burimet për një gjykim të shpejt dhe të drejt të mosmarrëveshjeve. Në vend se të jepen licencat në bazë të parimit “vjen i pari, shërbehesh i pari”, Kosova duhet ti tenderoj licencat në një proces të integruar. Komuniteti relativisht i vogël i kompanive aktive në industrinë nxjerrëse në Kosovë mundëson ekzistim e një sistemi ku me rastin e aplikimit të një kompanie për licencë, mund të informohen edhe kompanitë e tjera të regjistruara të cilat mund të dorëzojnë ofertat e tyre për licencën. Ofertimi garues do të rezultonte në një ndarje më pak arbitrare të licencave, dhe do të ndihmonte në sigurimin e vlerave më të mëdha për Kosovën. Tenderët mund të ndihmojnë në tejkalimin e deficitit të informatave që qeveria mund ketë në krahasim me kompanitë ndërkombëtare. Sistemi i e-tenderimit që është analog i atij të themeluar në shtetin indian të Uttar Pradesh në vitin 2012, do i mundësonte Kosovës të bënte këtë ndryshim të politikave në një mënyrë që është transparente për të gjithë akterët, si dhe të jetë e shpejt dhe efikase.



## **4. Të siguroj shpалosjen e plotë publike të licencave dhe informatave të kontratave përmes portalit online të kadastrit të minierave**

Një nga kërkesat kryesore për qeverisje të mirë në sektorin e industrive nxjerrëse është ekzistimi i një regjistri të qasshëm publik që ofron informata të plota mbi çdo licencë përkatëse dhe u mundëson palëve të interesuara - duke përfshirë edhe publikun e gjerë - të dini se sa licenca ekzistojnë, lokacionet e tyre si dhe identitetin e kompanive që i mbajnë ato. Integrimi i një sistemi publik të e-tenderimit do të lejojë integrimin në kohë reale të informatave në dispozicion. Të dhënat të cilat duhet të shpалosen në një regjistër të tillë përfshijnë:

- Mbajtësin e licencës
- Koordinatat e fushës së licencimit
- Data e aplikimit, çmimin, dhe kohëzgjatja
- Për licencat e eksplotimit, mallin që prodhohet
- Pronësinë e përfituese e kompanisë mbajtëse të një licence
- Kontratat dhe marrëveshjet e tjera të ndërlidhura me licencën
- Nivelet e prodhimit ashtu siç përcaktohen nga raportet tre-mujore
- Pagesat në nivel të projektit të bëra nga kompanitë për qeverinë në baza vjetore (rentat minerare, gjobat, gjobat administrative, tatimet).

Sistemi i regjistrimit të licencave duhet të implementohet në formë të një portali online që është publikisht i qasshëm dhe përfshinë funksionet e “kërkimit” dhe “filtrimit” si dhe një ndër-faqe GIS për të shfaqur zonat e licencës në një hartë topografike. Ekzistimi i një sistemi të tillë njihet si praktikë e mirë në kuadër të standardeve të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (NTIN). Për të parë një shembull të zbatimit të mirë të një sistemi të tillë, Kosova duhet të shikoj portalin e kadastrit të minierave të Ministrisë së Resurseve Minerale të Mozambikut.

## **5. Implementimi i një sistemi më të mirë për menaxhimin e ankesave në mënyrë që publiku të raportoj shkeljet e mundshme të licencave dhe çështje të ngjashme**

Sistemi plotësisht funksional për menaxhimin e ankesave është një prej mekanizmave kyç për ndërtimin e besimit në mbikëqyrjen efektive të veprimtarisë nxjerrëse. KPMM tashmë ka një sistem rudimentar të menaxhimit të ankesave, por megjithatë duhet të shqyrtoj përmirësimin e tij në një sistem që bazohet më pak në intervenimin e drejtpërdrejt nga njeriu për qëllime themelore informative. Për shembull, qytetarët duhet të jenë në gjendje të raportojnë problemet, shqetësimet dhe ankesat

përmes një numri të kanaleve përfshirë këtu edhe ueb-faqen, SMS, dhe përgjigjeve interaktive me zë (IVR). Secila parashtrësë në sistem duhet të krijoj një raport, dhe kushdo që e ka dorëzuar raportin duhet të informohet automatikisht për statutin dhe zgjedhjen e raportit gjatë progresit të rastit. Sistemi gjithashtu duhet të i mundësoj KPMM të publikoj informata dhe statistika mbi çështjet e raportuara, statusin dhe zgjedhjen në kohë reale.

## **6. Përshpejtimi i procesit gjyqësor për shkelje në industrinë nxjerrëse, dhe shqiptimi i gjobave më të përshtatshme**

Një nga problemet kyçe të vërejtura është efikasiteti i procesit gjyqësor. Duke pasur parasysh natyrën e veçantë të sektorit minerar në ndërgjegjen e publikut, si dhe dëmet e konsiderueshme dhe afatgjate mjedisore dhe sociale që shkeljet e rregulloreve të sektorit nxjerrës mund të shkaktojnë, atëherë brenda sistemit prokurorial dhe gjyqësor në Kosovë duhet të krijohet një proces i veçantë i përshpejtuar në rastet e shkeljeve të licencës të raportuara nga KPMM-ja. Si standard i synuar duhet të jetë që gjykimi i rasteve të ndërlidhura me sektorin e industrive nxjerrëse të jetë më i shkurtër se 6 muaj. Për më tepër, duhet të përcaktohen gjobat që të pasqyrojnë dëmet mjedisore, sociale dhe ekonomike të shkaktuara nga operacionet e paligjshme nxjerrëse. Përshpejtimi i procesit gjyqësor dhe vendosja e gjobave më adekuate do të rezultojë me parandalim më të mirë të operacioneve të parregulluara të sektorit të industrive nxjerrëse.

## **9. Shpalosja e plotë e të ardhurave vjetore të lidhura me mineraret (tatimet, rentat minerare dhe të ardhurat e tjera) në një format special të bazuar në të dhënat nga matjet gjeodezike**

Përveç që licencat duhet të jenë në dispozicion të publikut përmes sistemit online të kadastrit të minierave, KPMM duhet të hartoj një raport vjetor të të ardhurave të ndërlidhura me sektorin e industrive nxjerrës në fund të secilit vit financiar. Ky raport duhet t'i kushtoj vëmendje të veçantë të ardhurave të ndërlidhura nga veprimtaritë nxjerrëse me të ardhurat nga vitet e mëparshme, duke u bazuar në të dhënat e matjeve gjeodezike dhe në të dhënat afat-gjate të tregut.

## **10. Komunikimi publik pro-aktiv në të gjitha çështjet që ndërlidhen me politikën e minierave**

Departamenti i minierave dhe mineraleve në MZHE, KPMM-ja dhe në Kuvendi i Kosovës duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje komunikimit më të mirë të ndryshimeve të politikave dhe çështjeve të tjera të ndërlidhura me veprimtarinë e sektorit nxjerrës. Megjithëse është e mundshme që

Kosova do të mbetet një prodhues modest i mallrave minerale, përfshirë këtu edhe thëngjillin, sektori i industrisë nxjerrëse është në vëmendje publike për shkak të rëndësisë ekonomike të sektorit dhe vështirësive ekonomike të hasura nga grupet e mëdha të popullsisë. Në një mjedis të tillë, vakumi informativ për çështjet e ndërlidhura me sektorin është mbushur shpejt me thashethemet në lidhje me operacionet e paligjshme dhe korrupsionin. Përveç fushatave të informimit publik, qeveria duhet publikisht të mbështesë iniciativat e shoqërisë civile dhe mediave siç është iniciativa e Kallxo.com, që shërbejnë si një mjet informimi për qytetarët e interesuar për veprimtarit e paligjshme dhe rryshfetin.

---

## BIBLIOGRAFIA

Blau, Uri (2011). *Israeli Black Hole in Kosovo*. In: Haaretz, August 12, 2011. Retrieved from <http://www.haaretz.com/israel-news/israeli-black-hole-in-kosovo-1.378338>

Brunwasser, Matthew (2015). *Steamrolled. A Special Investigation of Doing Business Abroad*. In: Foreign Policy. Retrieved from <http://foreignpolicy.com/2015/01/30/steamrolled-investigation-bechtel-highway-business-kosovo/>

Cani, Bahri (2015). *Chill Returns to Kosovo and Serbia*. In: Deutsche Welle, November 15, 2015. Retrieved from <http://www.dw.com/en/chill-returns-to-kosovo-and-serbia/a-18850857>

Collaku, Petrit and Fatmir Aliu (2012). *Wesley Clark Seeks Licence For Oil in Kosovo*. In: Balkan Insights, June 8, 2012. Retrieved from <http://www.balkaninsight.com/en/article/wesley-clark-seeks-licence-for-oil-in-kosovo>

Collaku, Petrit et al (2014). *Albania-Kosovo Highway Costs Soar To 2 Billion Euros*. In: BalkanInsight, April 23, 2014. Retrieved from <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-kosovo-highway-costs-soar-to-2-billion-euro>

Drejtësia në Kosovë (2013a). *Korrupsioni Ne KPMM*. In: Drejtësia në Kosovë, December 22, 2013. Retrieved from <http://www.drejtesianekosove.com/sq/Emisione/Korrupsioni-ne-KPMM-1054>

Drejtësia në Kosovë (2013b). *Ekspluatimi Ilegal I Zhavorrit*. In: Drejtësia në Kosovë, June 23, 2013. Retrieved from <http://www.drejtesianekosove.com/sq/Emisione/Ekspluatimi-ilegal-i-zhavorrit-1026>

Drejtësia në Kosovë (2014). *Ekspluatimi Ilegal I Zhavorrit Në Rajonin E Dukagjinit*. In: Drejtësia në Kosovë, May 4, 2014. Retrieved from <http://www.drejtesianekosove.com/sq/Emisione/Ekspluatimi-Ilegal-i-Zhavorrit-ne-Rajonin-e-Dukagjinit-1096>

Esser, Christian, Sha Hua and Martina Morawietz (2015). *Allianz will Investments aus der Kohleindustrie abziehen*. In: ZDF Frontal21, November 24, 2015. Retrieved from <http://www.zdf.de/frontal-21/allianz-ausstieg-aus-der-kohle-41104912.html>

Extractive Industries Transparency Initiative (2013). *The EITI Standard*. Oslo: EITI Secretariat. Retrieved from [https://eiti.org/files/English\\_EITI%20STANDARD\\_11July\\_0.pdf](https://eiti.org/files/English_EITI%20STANDARD_11July_0.pdf)

Government of Kosovo (2012). *Mining Strategy of the Republic of Kosovo 2012 – 2025*. Pristina: Ministry of Economic Development. Retrieved from [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Strategjia\\_Minerare\\_e\\_R.\\_Kosoves\\_2012\\_-\\_225\\_\\_Ang.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Strategjia_Minerare_e_R._Kosoves_2012_-_225__Ang.pdf)

Government of Kosovo (2014). *Statistical Yearbook of the Republic of Kosovo 2014*. Pristina: Kosovo Agency of Statistics. Retrieved from <https://ask.rks-gov.net/ENG/dmdocuments/STATISTICAL%20YEARBOOK%202014.pdf>

Government of Kosovo (2015). *2015 National Economic Reform Program (NERP)*. Pristina: Government of Kosovo. Retrieved from <https://mf.rks-gov.net/en-us/Reports/Reports-and-Publications/National-Economic-Reform-Programme>

Grigg, Angus (2015). *BHP and Rio are quietly exciting coal*. In: Australian Financial Review Weekend, December 2, 2015. Retrieved from <http://www.afr.com/business/mining/coal/bhp-and-rio-tinto-are-quietly-exiting-coal-20151202-gldo0o>

Hopkins, Valerie (2015). *Set the Trojan Horse on Fire*. In: Foreign Policy, February 4, 2015. Retrieved from <http://foreignpolicy.com/2015/02/04/set-the-trojan-horse-on-fire-kosovo-serbia-protests-mining/>

Hower, Mike (2015). *Morgan Stanley, Wells Fargo Join Banks Cutting Out Coal*. In: Sustainable Brands, December 1, 2015. Retrieved from: [http://www.sustainablebrands.com/news\\_and\\_views/behavior\\_change/mike\\_hower/morgan\\_stanley\\_wells\\_fargo\\_join\\_banks\\_cutting\\_out\\_coal](http://www.sustainablebrands.com/news_and_views/behavior_change/mike_hower/morgan_stanley_wells_fargo_join_banks_cutting_out_coal)

ICG (1999). *Trepca. Making Sense of the Labyrinth*. ICG Balkans Report Nr. 82. Washing and Pristina: International Crisis Group. Retrieved from [http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/Kosovo%2015.pdf](http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/europe/Kosovo%2015.pdf),

KosovaReport (2005). *World Bank survey puts Kosovo's mineral resources at 13.5bn euros*. Retrieved from <http://kosovareport.blogspot.com/2005/01/world-bank-survey-puts-kosovos-mineral.html>

Liridon Llapashtica (2015). *Mbi 200 gurëthyes, demolojnë Kosovën*. In: Zeri, June 25, 2015. Retrieved from <http://zeri.info/ekonomia/38764/mbi-200-gurethyes-demolojne-kosoven/>

Novethic (2015). *Risque Carbone. Conséquences Financières de la Dévalorisation des Energies Fossiles*. Retrieved from <http://www.novethic.fr/climat/risque-carbone.html>

Office of the Auditor General (2015). *Audit Report on the Statement of the Commissions for Mines and Minerals for the Year Ended 31 December 2014*. Pristina: office of the Auditor General. Retrieved from [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KPMM\\_2014\\_Eng\\_377341.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPMM_2014_Eng_377341.pdf)

Olters, Jan-Peter (2014). *Energy Mineral Operations: Sustainability and FDI*. Pristina: Speech at Regional Environment Center and Baker Tilly Kosovo Conference. Retrieved from <http://www.worldbank.org/en/news/speech/2014/06/03/remarks-jan-peter-olters-regional-environment-center-baker-tilly-kosovo-conference>

Shllaku, Luan and Ekrem Beqiri (2007). *A Modern Tale – Kosova C 2100*. Pristina: Kosovo Foundation for Open Society. Retrieved from <http://kfos.org/wp-content/uploads/2012/04/A-Modern-Tale.pdf>

Transparency International (2014). *Corruption Perceptions Index 2014: Results*. Retrieved from: <http://www.transparency.org/cpi2014/results>

UNDP Kosovo Info Kosovo. Retrieved from <http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/Kosovoinfo.html>

UNODC (2011). *Corruption in Kosovo: Bribery as Experienced by the Population*. Vienna: UNDOC. Retrieved from [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/CORRUPTION\\_KOSOVO\\_Population.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/CORRUPTION_KOSOVO_Population.pdf)

USGS (2014). *2012 Minerals Yearbook. Europe and Central Eurasia [Advance Release]*. Reston, VA: U.S. Geological Service. Retrieved from <http://minerals.usgs.gov/minerals/pubs/Kosovo/2012/myb3-sum-2012-europe-eurasia.pdf>


World Bank (2012). *The World Bank Group Support to Kosovo's Energy Sector*. Washington, DC: World Bank Group. Retrieved from [http://siteresources.worldbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/297769-1329940905064/kosovo\\_slideshow.pdf](http://siteresources.worldbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/297769-1329940905064/kosovo_slideshow.pdf)

World Bank (2015). *World Development Indicators*. Retrieved from <http://databank.worldbank.org/data/reports.aspx?source=2&Kosovo=KSV&series=&period=>

World Bank Overview Kosovo. Retrieved from <http://www.worldbank.org/en/Kosovo/kosovo/overview>

World Bank (2015). *World Bank Data*. Retrieved from <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.TOTL.RT.ZS>

Xharra, Jeta and Petrit Collaku (2012). *Fox Marble Cries Foul Over Kosovo Lost Licenses*. In: Balkan Insights, December 10, 2012. Retrieved from <http://www.balkaninsight.com/en/article/fox-marble-cries-foul-over-kosovo-lost-licenses>



United Nations  
Development Programme  
(UNDP)  
Kosovo Office  
Zagrebi St. No. 39,  
10000 Pristina, Kosovo  
Phone: +381 (0) 38 249066  
Fax: +381 (0) 38 249065  
[registry.ks@undp.org](mailto:registry.ks@undp.org)  
[www.ks.undp.org](http://www.ks.undp.org)  
[@undp\\_kosovo](https://www.instagram.com/undp_kosovo)